

## KUJTESË

### **Për kriteret që duhet të plotësojnë grupet e interesit për të qenë përdorues efektiv të Sistemit elektronik të Bazës së të dhënave për çmimet e referencës PRDB.**

Drejtoria e Databazës dhe Studimit të Tregut (DDBST) për implementimin e Programit IPARD ka përgatitur dhe ka vënë në funksionim Sistemin elektronik për Bazën e të dhënave të çmimeve të referencës (Sistemi PRDB).

Funksionimi i këtij Sistemi do të bëjë procedurat për përcaktimin e çmimeve të arsyeshme për investimet në Programin IPARD më transparente dhe më eficientë duke shkurtuar në maksimum afatet e përpunimit të aplikimeve për të përfituar mbështetje nga Programi IPARD

Përdorimi i tyre nga subjektet ofertuese, të cilat ofrojnë zërat/asetet/shërbimet e tyre në funksion të investimeve në Programin IPARD, shton mundësitë e tyre për investime në Shqipëri.

Sistemi PRDB përbëhet nga disa aplikacione të pavarura operative të lidhura (të quajtura "module"). Këto module të bazës së të dhënave nuk janë të lidhura me masat e ndryshme mbështetëse të Zhvillimit Rural, por janë të organizuara sipas llojit të shpenzimeve:

- Makineri/pajisje dhe linja
- Punime ndërtimi dhe instalimi në tre seksione;
- Krijimi dhe restaurimi i pemëtoreve (Shërbime bujqësore), në dy seksione.

Sistemi PRDB është i arritshëm edhe nga Subjektet të cilët janë të interesuar të ofrojnë zërat/asetet/shërbimet e tyre në funksion të investimeve në Programin IPARD.

Sistemi PRDB është i arritshëm për Aplikantët potencial që janë të interesuar për të përfituar mbështetje financiare nga Programi IPARD.

Për të bashkëpunuar me AZHBR-në, subjektet e interesuara të konkurrojnë për të lidhur një kontratë për realizimin e investimeve të parashikuara në Programin IPARD, duhet të plotësojë disa kritere.

*Së pari subjektet duhet të regjistrohen në Sistemin elektronik të Bazës së të dhënave të Çmimeve të referencës PRDB.*

Të drejtën për tu regjistruar e kanë të gjithë subjektet që kryejnë aktivitetin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të regjistruar në QKB dhe kanë status “Aktiv” si dhe subjektet e huaja të cilat nuk janë të regjistruar në QKB në Shqipëri por aktivitetin e tyre e zhvillojnë sipas legjislacionit të tyre kombëtar.

Për subjektet e huaja, të cilat nuk janë të regjistruara në QKB në Shqipëri, fushat e investimit të jenë të parashikuara në “Regjistri i firmës” sipas legjislacionit të tyre kombëtar si dhe statusi i tyre duhet të jetë “Aktiv”.

Subjektet e interesuara nënshkruajnë dhe dërgojnë në AZHBR “Marrëveshje bashkëpunimi” (tip) dhe regjistrimi bëhet efektiv pas nënshkrimit nga AZHBR.